



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 17.03.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11, 13 dhe 58.a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 8,9 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale dhe Përfundimit nr. 06-16174-13/1 i miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të dt. 26.02.2015, më të cilin është aprovuar kërkesa e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim për subvencionimin e aktiviteteve të Qendrës për Komunitete në Brekoc e cila menaxhohet nga “Bethani Christian Service”, me dt. 17.03.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

I. Miratohet kërkesa e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, e cila është e ndërlidhur me kërkesën e OJQ “Bethani Christian Service” nr. 16-400-13731 e dt. 16.02.2015 për subvencionimin e aktiviteteve të Qendrës për Komunitete në Brekoc për ngritjen e cilësisë së mësimin të fëmijëve parafillorë dhe parashkollorë të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione komunale në vlerë prej 5,700.00€.

II. Autorizohet Drejtorja për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë totale prej 5.700.00€ nga subvencionet e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirlogarinë e OJQ “Bethani Christian Service” nr. 1505001000052757 – Raiffsen Bank, sipas të dhënave vijuese:

Për këstin e parë, pagesa bëhet në vlerë 3,500.00€

Për këstin e dytë, pagesa bëhet në vlerë prej 2,200.00€

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

IV. Vendimi iu dërgohet :

- Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Z. Berat Thaqi, drejtor i programit të OJQ Bethani, Gjakovë
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari - Lila

